



MISIONI I ODIHR-IT PËR VËZHIMIN E ZGJEDHJEVE

Republika e Maqedonisë së Veriut - Zgjedhjet lokale, Rrethi i dytë, 2 nëntor 2025

DEKLARATË PËR GJETJET DHE PËRFUNDIMET PARAPRAKE

PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Zgjedhjet e rrethit të dytë për kryetar komuna, të mbajtura më 2 nëntor, u ofruan votuesve një zgjedhje të qartë midis alternativave të dallueshme politike, por jo të gjithë kandidatët patën kushte të barabarta fushate. Në veçanti, formula e mangët e ndarjes së reklamave politike e shtrembëroi ndjeshëm terrenin për garë në media në disa zgjedhje për kryetar komune. Fushata në shumicën e komunave ishte konkurruese, por ndarjet përgjatë vijave etnike i përcaktuan disa gara. Përfshirja e vazhdueshme e funksionarëve qeveritarë në fushatë, si dhe pretendimet e vazhdueshme për presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe votuesit, si dhe pretendimet e shumta për blerje votash, ishin shqetësuese. Administrata zgjedhore i menaxhoi përgatitjet në mënyrë efikase dhe transparente, përkundër faktit se disa aspekte të rëndësishme procedurale të rrethit të dytë nuk ishin të rregulluara qartë në ligj, dhe ajo vazhdoi të gëzonte besimin e shumicës së palëve të interesuara. Trajtimi i kundërshtimeve të rrethit të parë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) ngriti shqetësime në lidhje me procesin e rregullt ligjor dhe të drejtën për mjet juridik efektiv, ndërsa Gjykata Administrative i shqyrtoi ankesat plotësisht dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në mbledhje publike. Kërkesat e kufizuara për raportim të financimit të fushatës dhe mungesa e veprimeve mbikëqyrëse e dëmtuan transparencën dhe besimin publik dhe e zvogëluan llogaridhënien e procesit zgjedhor, gjë që është në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare. Në ditën e zgjedhjeve, në numrin e kufizuar të vendvotimeve të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it, fazat e ndryshme të procesit u vlerësuan si të organizuara mirë, profesionale dhe të qeta, ku në përgjithësi u respektuan procedurat e përcaktuara, megjithëse ndjekja e votuesve ishte çështje shqetësuese.

Rrethi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune u zhvillua në 32 komuna dhe në Qytetin e Shkupit, ku asnjë kandidat nuk kishte fituar shumicën absolute në rrethin e parë që u mbajt më 19 tetor. Vetëm një grua u zgjodh kryetare komune në rrethin e parë dhe tre prej tyre vazhduan në rrethin e dytë. Po ashtu, vetëm një parti që përfaqësonte një bashkësi më të vogël etnike kishte kandidat në rrethin e dytë.

Megjithëse Kodi Zgjedhor rregullon disa aspekte të procesit zgjedhor të rrethit të dytë, disa fusha kyçe mbeten të parregulluara, të paqarta ose të detajuara në mënyrë të pamjaftueshme. Ato përfshijnë mungesën e dispozitave që e përcaktojnë fillimin zyrtar të fushatës për rrethin e dytë, gjë që ndikon në kërkesat e raportimit të financimit të fushatës, mbulimin e fushatës dhe rregullat e reklamimit në media. Ligjit gjithashtu i mungon një afat i qartë kohor dhe rregulla të hollësishme për përgatitjet teknike për votim.

Administrata zgjedhore vazhdoi të menaxhonte përgatitjet zgjedhore në mënyrë efikase dhe transparente, dhe në përgjithësi gëzonte besimin e palëve të interesuara. Mbledhjet e KSHZ-së ishin të hapura për mediat dhe vëzhguesit dhe u transmetuan online. Midis dy rretheve, KSHZ-ja zhvilloi sesione trajnimi për rifreskim të njohurive dhe i përmbledhi pyetjet më të shpeshta nga organet e nivelit më të ulët të menaxhimit të zgjedhjeve dhe i shpërndau përgjigjet si material shtesë trajnimi. Ligji nuk parashikon përditësime të listës së votuesve midis rretheve zgjedhore, përveç rasteve kur parashtrihen kërkesa shtesë për votim në shtëpi dhe kur KSHZ-ja ka marrë vendime mbi kundërshtimet e votuesve në lidhje me shkeljen e të drejtave të votimit.

Sikurse edhe në rrethin e parë, u respektuan liritë themelore të bashkimit, tubimit, dhe shprehjes, dhe kandidatët kishin mundësi të zhvillonin fushatë në mënyrë të lirshme. Fushata ishte konkurruese, dhe

votuesit patën mundësi të vërtetë zgjedhjeje midis alternativave politike. Toni i fushatës ishte më i përmbajtur sesa në rrethin e parë, por ndonjëherë ishte nxitës, me disa raste të sulmeve personale. Përfshirja e vazhdueshme e funksionarëve qeveritarë në fushatë, nganjëherë e zbehu vijën ndarëse midis shtetit dhe partisë, në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990. Vazhduan pretendimet për presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe votuesit, si dhe pretendimet e shumta për blerje votash.

Garuesit, partitë, dhe kryetarët e partive zhvilluan fushatë aktive në Facebook, me ç'rast një numër kryetarësh aktualë të komunave dhe ministrash të qeverisë i përdorën edhe llogaritë e tyre zyrtare në rrjetet sociale për zhvillim të fushatës. Disa garues ngritën shqetësime në lidhje me narrativet manipuluese në rrjetet sociale, e po ashtu u potencuan edhe një numër rastesh të retorikës nxitëse.

Kërkesat për raportimin e financimit të fushatës për rrethin e dytë mbetën të kufizuara, gjë që e dëmtoi transparencën. Asnjë nga institucionet e ngarkuara me mbikëqyrjen e financimit të fushatës nuk inicioi procedura kundër garuesve që nuk i përmbushën kërkesat për raportim para rrethit të parë, duke e dobësuar më tej besimin e publikut në procesin zgjedhor dhe duke e zvogëluar llogaridhënien e tij, gjë që është në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare.

Formula e mangët e ndarjes së reklamave politike në media, e cila i vë në disavantazh kandidatët e pavarur dhe partitë joparlamentare dhe në mënyrë efektive i përjashton partitë më të vogla me grup parlamentar, e shtrembëroi ndjeshëm terrenin për garë në garat e rrethit të dytë që përfshinin kandidatët të tillë, gjë që është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe praktikën e mira ndërkombëtare. Monitorimi i mediave nga Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i ODIHR-it së zbuloi se toni i mbulimit në programet e lajmeve të të gjithë transmetuesve të monitoruar ishte në përgjithësi neutral. Kandidatët e pavarur u mbuluan kryesisht përmes lajmeve.

KSHZ-ja shqyrtoi 51 kundërshtime në lidhje me procedurat e ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë në një mbledhje publike dhe i hodhi poshtë ose i refuzoi të gjitha. Jo të gjitha kundërshtimet u shqyrtuan individualisht, pasi disa prej tyre u vendosën në mënyrë të përbashkët për shkak të përmbajtjes së ngjashme. Kjo, në kombinim me qasjen tepër formaliste të KSHZ-së, e kufizoi hetimin e disa rasteve dhe e minoi të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe ngriti shqetësime në lidhje me procesin e rregullt ligjor, gjë që është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet dhe praktikën e mira ndërkombëtare. Për katërmbëdhjetë vendime të KSHZ-së u parashtruan ankesa në Gjykatën Administrative, e cila i miratoi ankesat dhe i rrëzoi vendimet e KSHZ-së në katër raste, ndërsa i hodhi poshtë dhjetë rastet e tjera, duke i lënë në fuqi vendimet e KSHZ-së.

Në numrin e kufizuar të vendvotimeve të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it, procesi zgjedhor u vlerësua si i organizuar mirë, profesional dhe i qetë. Gjatë votimit, në përgjithësi u respektuan procedurat e përcaktuara dhe vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it nuk raportuan incidente ose mangësi serioze procedurale nga vendvotimet e vëzhguara, megjithëse u vunë re raste të shumta të ndjekjes së votuesve. Në vendvotimet e vëzhguara, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultateve u vlerësuan si transparente, profesionale dhe efikase dhe në përgjithësi u kryen në përputhje me procedurat e përcaktuara.

GJETJET PARAPRAKE

Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve të rrethit të parë dhe zhvillimet pas zgjedhjeve

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) i shpalli rezultatet paraprake të zgjedhjeve lokale të 19 tetorit më 20 tetor, rreth 14 orë pas afatit ligjor prej 12 orësh nga mbyllja e votimit.¹ Dyzet e katër kryetarë komune u zgjodhën në rrethin e parë, duke përfshirë 33 kandidatë të emëruar nga koalicioni i udhëhequr nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), 5 nga koalicioni VLEN i shqiptarëve etnikë dhe nga 3 kryetarë komunash u zgjodhën nga koalicionet e udhëhequra nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) dhe Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) i shqiptarëve etnikë. Vetëm një nga 32 kandidatet gra për kryetare komune u zgjodh në rrethin e parë. Në katër komuna, zgjedhjet për kryetar komune ishin të pavlefshme pasi në zgjedhje morën pjesë më pak se një e treta e votuesve të regjistruar.²

Në zgjedhjet për këshillat komunalë, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja fitoi 549 nga 1.307 mandate të këshillave komunalë, duke shënuar një rritje të përgjithshme të numrit të mandateve, ndërsa koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja siguroi 230 mandate, duke shënuar një rënie të dukshme. Koalicioni i udhëhequr nga BDI siguroi 169 mandate, koalicioni VLEN 128, “Levica” 66, “Për Maqedoninë Tonë” (ZNAM) 44 dhe Partia Demokratike e Turqve 21, ndërsa partitë më të vogla fituan gjithsej 47 mandate. Përveç kësaj, u zgjodhën 53 kandidatë të pavarur. KSHZ-ja njoftoi se 53.713 fletëvotime (rreth 6 për qind e të gjitha votave të hedhura) janë shpallur të pavlefshme.³

Më 23 tetor, KSHZ-ja i shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve në të cilat nuk ishte parashtruar asnjë kundërshtim, duke përfshirë zgjedhjet për këshillat komunalë në 64 komuna dhe zgjedhjet për kryetar komune në 33 komuna, ku kryetari i komunës u zgjodh në rrethin e parë. Më 28 tetor, pasi u shteruan të gjitha mjetet juridike që janë në dispozicion në lidhje me rrethin e parë (shih *Zgjidhja e kontesteve zgjedhore*), KSHZ-ja i shpalli rezultatet përfundimtare për komunat e mbetura.⁴ Rrethi i dytë u caktua në 32 komuna dhe në Qytetin e Shkupit. Nuk ka kërkesë për pjesëmarrje të votuesve në rrethin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune dhe kandidati që fiton më shumë vota shpallet i zgjedhur. Kandidatët nga koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja morën pjesë në 26 gara për kryetar komune në rrethin e dytë, ata nga koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja në 17, nga koalicioni i udhëhequr nga BDI-ja dhe VLEN-i në 5 gara secila, ZNAM-i në 2, koalicioni “Përvoja për Sukses” në 1, ndërsa në rrethin e dytë kaluan edhe 8 kandidatë të pavarur. “Levica” kishte një kandidat për kryetar komune për Qytetin e Shkupit. Nga partitë që përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike që garuan në mënyrë të pavarur në rrethin e parë, vetëm Unioni i Romëve kishte kandidat në rrethin e dytë, edhe atë në Shuto Orizarë. Vetëm 3 nga kandidatët e rrethit të dytë ishin gra.

Situata pas ditës së zgjedhjeve mbeti e qetë. Pas shpalljes së rezultateve paraprake, përfaqësuesit e VMRO-DPMNE-së kërkuar dorëheqjen e kryetarit të LSDM-së, Venko Filipçe, ndërsa VLEN-i kërkoi

¹ KSHZ-ja e informoi Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) të ODIHR-it se ishte teknikisht e pamundur të përmbushej ky afat.

² Qendër Zhupa (21,49 për qind), Vrapçishti (25,18 për qind), Mavrova dhe Rostusha (30,31 për qind) dhe Gostivari (33,31 për qind). Zgjedhjet për kryetar komune në këto komuna do të duhet të përsëriten brenda 60 ditëve nga publikimi i rezultateve përfundimtare.

³ Neni 110 i Kodit Zgjedhor përcakton se votuesi duhet ta rrethojë numrin rendor të kandidatit ose listës për të cilin/cilën dëshiron të votojë. Neni 115, paragrafi 2, i përcakton fletëvotimet e vlefshme në mënyrë mjaft të gjerë, edhe atë si ato në të cilat vullneti i votuesit mund të përcaktohet në mënyrë të sigurt dhe pa mëdyshje. Udhëzimi përkatës i KSHZ-së, që është në fuqi që nga viti 2015, i përcakton fletëvotimet e vlefshme vetëm si ato në të cilat garuesit (numri i tyre rendor në fletëvotim, logoja, emri, ose të gjitha këto) janë rrethuar me stilolaps me ngjyrë të kaltër.

⁴ Neni 135(2) i Kodit Zgjedhor përcakton që KSHZ-ja duhet t'i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve menjëherë, dhe jo më vonë se 24 orë nga dita kur ato bëhen përfundimtare.

që kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, të jepte dorëheqje. Koalicioni i udhëhequr nga BDI-ja e përsëriti kërkesën e tij për zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Korniza ligjore

Kodi Zgjedhor i rregullon vetëm disa aspekte të procesit zgjedhor të rrethit të dytë, kryesisht ato që lidhen me fushatën dhe financimin e fushatës.⁵ Megjithatë, disa fusha kyçe mbeten të parregulluara, të paqarta ose të detajuara në mënyrë të pamjaftueshme, duke përfshirë mungesën e dispozitave që e përcaktojnë fillimin zyrtar të fushatës së rrethit të dytë, gjë që ndikon në kërkesat për raportim financiar të fushatës, mbulimin e fushatës dhe reklamimin në media. Përveç kësaj, kishte mungesë të afatit kohor dhe rregullave të qarta për përgatitjet teknike për votimin, përbërjen dhe funksionimin e administratës zgjedhore, dhe përdorimin e billbordeve gjatë fushatës së rrethit të dytë, si dhe për procedurat për akreditimin e vëzhguesve dhe përfaqësuesve të autorizuar të kandidatëve midis dy rretheve zgjedhore.

Administrata zgjedhore

Garat për kryetar të komunave në rrethin e dytë u administruan nga KSHZ-ja, 32 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK) dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit (KZQSh) dhe 1.777 Këshilla Zgjedhore (KZ), me ndryshime minimale në përbërjen e KZK-ve dhe KZ-ve midis dy rretheve zgjedhore. Pas rrethit të parë, KSHZ-ja përpiloi një listë me pyetjet më të shpeshta nga KZK-të dhe KZ-të, së bashku me përgjigjet përkatëse, dhe ua shpërndau atë zyrtarëve zgjedhorë si material shtesë trajnimi.⁶ Informimi dhe edukimi i votuesve nga ana e KSHZ-së vazhdoi midis rretheve zgjedhore.

Administrata zgjedhore vazhdoi të menaxhonte përgatitjet zgjedhore në mënyrë efikase dhe transparente, dhe në përgjithësi gëzonte besimin e palëve të interesuara. Megjithatë, më 25 tetor, anëtarët e KZK-së së Shuto Orizarës deklaruan në një letër të hapur se kishin marrë kërcënime me vdekje nga kryetari aktual i komunës dhe bashkëshortja e tij, të cilët kishin pretenduar mashtrime zgjedhore dhe kishin parashtruar disa ankesa në lidhje me këtë, dhe njoftuan se do të bojkotonin rrethin e dytë nëse nuk u garantohej siguria (shih *Zgjidhja e kontesteve zgjedhore*). Pas vendimeve përkatëse të gjykatës, më 28 tetor, KSHZ-ja vendosi të përsërisë zgjedhjet për këshillin komunal të Shuto Orizarës në tre vendvotime më 2 nëntor, me dy KZ të reja të deleguara nga KZK-të fqinje, ku zgjedhjet përfunduan në rrethin e parë.⁷ KSHZ-ja gjithashtu i shkarkoi dy KZ-të fillestare dhe theksoi se do të dërgojë kërkesa në Prokurorinë Publike për t'i hetuar këto raste. Kalendarin zgjedhor i miratuar nga KSHZ-ja përcakton se afatet për përgatitjet e rrethit të dytë të zgjedhjeve janë të njëjta me ato të rrethit të parë, pa dhënë detaje shtesë. Midis dy rretheve zgjedhore, KSHZ-ja mbajti katër mbledhje, të cilat ishin të hapura për mediat dhe vëzhguesit dhe u transmetuan online.⁸

Ligji nuk parashikon përditësime të listës së votuesve midis rretheve zgjedhore, përveç rasteve kur parashtrohen kërkesa shtesë për votim në shtëpi dhe kur merren vendime për votuesit, kundërshtimet e të cilëve për shkelje të të drejtave të votimit janë pranuar nga KSHZ-ja. Sipas KSHZ-së, listat e votuesve për rrethin e dytë përfshinin gjithsej 1.013.357 votues, duke përfshirë 4.826 votues të regjistruar për votim në shtëpi, 1.256 votues në institucionet ndëshkuese dhe 214 votues të vendosur në institucionet e kujdesit social.

⁵ Ato përfshijnë dispozitat që lidhen me heshtjen zgjedhore, afatet për publikimin e anketave, rregullat për mbulimin mediatic, ndarjen e fondeve për reklamat e paguara politike dhe të kohës së transmetimit falas, kufizimet e shpenzimeve për fushatat e garuesve, kërkesat shtesë për raportimin për financimin e fushatës, si dhe për sistemin zgjedhor për rrethin e dytë.

⁶ MVZ-ja e ODIHR-it i vëzhgoi sesionet e trajnimit për rifreskim të njohurive për kryetarët e KZK-ve dhe zëvendësit e tyre në shumicën e komunave ku u mbajt rrethi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune.

⁷ Sipas KSHZ-së, baza ligjore për këtë vendim janë nenet 31.1 dhe 31.2 të Kodit Zgjedhor, të cilat i përcaktojnë kompetencat e përgjithshme të KZK-ve.

⁸ Mbledhjet e KSHZ-së rreth ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë u përkthyen në gjuhën maqedonase të shenjave, që ishte një hap pozitiv dhe gjithëpërfshirës drejt sigurimit të qasshmërisë për personat me dëmtim të dëgjimit.

As Kodi Zgjedhor e as udhëzimi i KSHZ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve nuk përmbajnë dispozita specifike për një rreth të dytë dhe as nuk e përcaktojnë statusin e përfaqësuesve të autorizuar të kandidatëve që nuk kualifikohen në rrethin e dytë. Megjithatë, KSHZ-ja e informoi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të ODIHR-it se akreditimet e vëzhguesve të lëshuara për rrethin e parë mbetën të vlefshme dhe se mund të akreditoheshin vëzhgues shtesë. KSHZ-ja regjistroi gjithsej 152 vëzhgues qytetarë midis rretheve zgjedhore.

Ambienti i fushatës dhe financimi i fushatës

Sikurse edhe në rrethin e parë, u respektuan liritë themelore të bashkimit, tubimit dhe shprehjes, dhe kandidatët kishin mundësi të zhvillonin fushatë në mënyrë të lirshme. KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se garuesit mund të rifillonin fushatën sapo të mbaronte heshtja zgjedhore, kur vendvotimet u mbyllën më 19 tetor. Për shkak të formulës së mangët për ndarjen e reklamave politike, ashtu sikurse edhe në rrethin e parë, partisë “Levica” dhe ZNAM-it nuk iu nda asnjë hapësirë për billborde.⁹ Në mungesë të rregulloreve të veçanta, shumica e reklamave politike në ambient të jashtëm nga fushata e rrethit të parë mbetën të dukshme gjatë gjithë rrethit të dytë. Fushata e rrethit të dytë përfundoi më 31 tetor.

Në përgjithësi, fushata ishte konkurruese, dhe votuesit patën mundësi të vërtetë zgjedhjeje midis alternativave politike. Disa kandidatë për kryetar komune rifilluan fushatën menjëherë pas shpalljes së rezultateve paraprake, ndërsa shumica rifilluan me aktivitete modeste disa ditë më vonë, duke u përqendruar në takime të vogla dhe në promovimin në rrjetet sociale.¹⁰ Më 23 dhe 24 tetor, respektivisht, kandidatët e pavarur për kryetarë komune në Makedonski Brod dhe në Mogillë njoftuan tërheqjen e tyre, duke i lënë kështu kandidatët e tjerë si garues të vetëm në ato komuna.¹¹ Koalicioni i udhëhequr nga BDI-ja dhe VLEN-i, të shqiptarëve etnikë, zhvilluan aktivitete të përbashkëta të fushatës në komunën e Brvenicës, duke e theksuar rëndësinë e përkatësisë etnike në përfaqësimin politik.¹² Megjithatë, pas kritikave publike nga kryeministri, VLEN-i u distancua nga kandidati.¹³ Mesazhet e shumicës së garuesve u përqendruan në çështjet e nivelit komunal, ndërsa kryetarët e partive në nivel kombëtar i potencuan edhe fitoret e tyre në rrethin e parë. Toni i fushatës ishte më i përmbajtur se në rrethin e parë, megjithatë pati disa raste të sulmeve personale midis kandidatëve, si dhe midis kryetarëve të partive.¹⁴

⁹ ZNAM-i e informoi MVZ-në e ODIHR-it se, ngjashëm me rrethin e parë, ata blenë hapësira për billborde që nuk u kërkuar nga partitë e tjera në komunën Qendër të Shkupit dhe në komunën e Kumanovës, ku kandidatët e tyre garuan në rrethin e dytë.

¹⁰ Midis dy rretheve zgjedhore, MVZ-ja e ODIHR-it vëzhgoi tre ngjarje të fushatës në tre komuna të ndryshme, ku nuk pati asnjë folësë grua. Në të tre ngjarjet morën pjesë si folës funksionarë të lartë të qeverisë. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja ishte i vetmi garues që mbajti një tubim të madh gjatë rrethit të dytë, i cili u zhvillua në Shkup më 30 tetor.

¹¹ Megjithatë, ky veprim nuk pati pasoja formale dhe kandidatët mbetën në fletëvotim, pasi ligji lejon tërheqjen vetëm brenda 48 orëve nga miratimi i listës përfundimtare të kandidatëve para rrethit të parë.

¹² Më 24 tetor, në një aktivitet fushate në Hamburg të Gjermanisë, Haqim Ramadani, kandidat i VLEN-it për Bërvenicën deklaroi: “komuna e Kërçovës dhe të gjitha komunat tjera ku janë shumicë shqiptare dhe gjithmonë do të udhëheqin shqiptarët... por duhet ta dinë të gjithë se kush është zot në vend të vet”.

¹³ Z. Ramadani nga ana tjetër u bëri thirrje zyrtarëve nga koalicioni i udhëhequr nga BDI-ja dhe VLEN-i që të mos merrnin pjesë në tubimin e tij.

¹⁴ Për shembull, më 28 tetor, kryetari aktual i komunës dhe kandidati i “Përvoja për Sukses” në Karposh, Stevço Jakimoski, e ftoi kundërshtarin e tij në debat, duke i thënë: “Nëse edhe këtë herë ke frikë, thirrje prindin tënd kujdestar Mickoskin”. Më 28 tetor, në një debat me kandidatin e VMRO-DPMNE-së, kandidati i partisë “Levica” për kryetar të Qytetit të Shkupit deklaroi: “Ti flet për ndërtimet pa leje, por bën fotografi me mbretin e ndërtimeve pa leje - Izet Mexhitin!”. Më 30 tetor, VMRO-DPMNE-ja lëshoi një deklaratë, duke iu referuar udhëheqësit të partisë “Levica” dhe kandidatit të tyre për Qytetin e Shkupit si “të majtët nga AliExpress-i”. Më 28 tetor, BDI-ja publikoi një postim në Facebook duke iu referuar VLEN-it: “Shqiptarët do të flasin qartë dhe me dinjitet - do t’i thonë JO vasalëve të VMRO-së”.

Vazhduan pretendimet për presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe votuesit.¹⁵ Përveç kësaj, MVZ-ja e ODIHR-it pranoi disa pretendime për blerje votash.¹⁶ Bartësit e funksioneve publike, duke përfshirë funksionarët e lartë qeveritarë, mbështetën kandidatët e partive të tyre dhe u angazhuan me votuesit në tubime.¹⁷ Një numër kandidatësh dhe ministrash vazhduan inaugurimet dhe vizitat në objektet e reja infrastrukturore.¹⁸ Disa kryetarë aktualë komune mbështetën kandidatë në komuna të tjera, duke ofruar përkohësisht shërbime publike atje.¹⁹ Këto praktika e forcuan avantazhin e kryetarëve aktualë dhe e zbehën vijën ndarëse midis shtetit dhe partisë, që është në kundërshtim me paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.²⁰ Që nga shpallja e zgjedhjeve, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) pranoi rreth 36 raportime, shumica prej të cilave pretendonin keqpërdorim të burimeve shtetërore dhe përpjekje për të ushtruar presion mbi votuesit. Ashtu sikurse edhe para rrethit të parë, KSHPK-ja nuk i trajtoi këto raporte si kundërshtime dhe për këtë arsye nuk i shqyrtoi ato para ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë.²¹

Garuesit zhvilluan fushatë aktive në Facebook, duke ndarë përmbajtje që nxirrnin në pah arritjet e kaluara, duke publikuar ngjarje të fushatës dhe duke premtuar zhvillime në nivel lokal.²² Llogaritë zyrtare të partive vazhduan të promovojnë kandidatët për kryetarë komunash, ndërsa një numër kryetarësh aktualë të komunave dhe ministrash i përdorën llogaritë e tyre zyrtare në Facebook për qëllime fushate. Nga nëntë nënshkruesit e Kodit të Sjelljes në Hapësirën Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve, “Levica” nuk iu përmbajt standardeve të Kodit për sa i përket gjuhës dhe retorikës së përdorur.²³ Disa konkurrentë ngritën shqetësime në lidhje me ngacmimet online, si dhe me narrativet

¹⁵ Në Çußer Sandevë, Krushevë dhe Kumanovë, MVZ-së së ODIHR-it iu raportuan pretendime për presion mbi punonjësit e sektorit publik. Pretendime për presion mbi votuesit u raportuan në komunën Qendër të Shkupit, Kumanovë, Probishtip dhe Tetovë.

¹⁶ Pretendime për blerje votash u raportuan nga komunat Qendër dhe Karposh të Shkupit, Kumanova dhe Tetova. Kandidati i VMRO-DPMNE-së në Karposh zhvilloi fushatë duke promovuar marrëveshjet me spitalin privat “Sistina” për të ofruar zbritje për ekzaminimet mjekësore për pensionistët dhe me Klinikën “Zhan Mitrev” për të ofruar shërbime falas për kontrole të kancerit.

¹⁷ Duke përfshirë kryeministrin dhe ministrat e mbrojtjes, mjedisit jetësor, punëve të jashtme, punëve të brendshme, vetëqeverisjes lokale dhe transportit.

¹⁸ Për shembull, më 22 tetor, kryetari aktual i komunës dhe kandidat i LSDM-së në Komunën Qendër të Shkupit inspektoi rikonstrukcionin e një kompleksi sportiv. Më 26 tetor, kandidati i pavarur në Strugë e vizitoi Qendrën Shëndetësore dhe Spitalin e Përgjithshëm në Strugë së bashku me Ministrin e Shëndetësisë, [duke postuar](#) në Facebook: “U dakordua se me bashkëpunim të sinqertë ndërmjet pushtetit lokal dhe atij qendror, me drejtësi dhe vullnet për punë, do të ndërtojmë një shërbim shëndetësor më të denjë për Strugën”. Më 28 tetor, ushtruesi i detyrës kryetar i komunës dhe kandidat i VMRO-DPMNE-së për Aerodromin, së bashku me Ministrin e Sportit, njoftuan ndërtimin e një salle të re sportive me vlerë 1 milion euro. Më 30 tetor, Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Transportit, në një tubim me kandidatin e VMRO-DPMNE-së për Brvenicën, deklaroi: “kryetari i komunës do të fitojë mandat të dytë këtu. ...Kemi rezervuar fonde shtesë në Ministrinë e Transportit dhe unë njoftoj se për ... Bërvenicën do të ketë një buxhet të veçantë, i cili do të jetë buxhet shtesë”.

¹⁹ Për shembull, kryetari aktual i komunës së Kumanovës dhe kryetar i ZNAM-it, Maksim Dimitrievski, dërgoi kamionë për mbledhjen e mbeturinave në komunën Qendër të Shkupit, të cilët kandidati i ZNAM-it i përdori në fushatën e tij; kryetarët e komunave të Ilindenit, Sopishtes dhe Zelenikovës ofruan shërbime të mbledhjes së mbeturinave në komunën e Aerodromit, e cila më pas u shfaq në fushatën e kandidatit të VMRO-DPMNE-së.

²⁰ Paragrafi 5.4 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990](#), kërkon “një ndarje të qartë mes shtetit dhe partive politike”.

²¹ Sipas ligjit, KSHPK-ja duhet t’i shqyrtojë dhe të vendosë për kundërshtimet që lidhen me shkeljet e rregullave të financimit të fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative brenda pesë ditëve.

²² Në rrethin e dytë, MVZ-ja e ODIHR-it ndoqi aktivitetet e fushatës së 30 llogarive në Facebook të partive politike, koalicioneve, kandidatëve dhe kryetarëve të partive.

²³ [Kodi](#) u bën thirrje garuesve të “përdorin... gjuhë shembullore dhe të sjellshme në komunikimin me publikun, dhe të respektojnë pikëpamjet dhe opinionet e ndryshme” dhe të “përmbahen dhe ta dënojnë fuqishëm përdorimin e gjuhës që nxit... diskriminim mbi çfarëdo baze”.

agresive dhe manipuluese në rrjetet sociale.²⁴ MVZ-ja e ODIHR-it vuri në dukje disa raste të retorikës nxitëse, duke përfshirë postimin plot urrejtje dhe përçmim të një këshilltari të sapozgjedhur kundër komunitetit rom, i cili u dënua nga disa organizata të shoqërisë civile dhe politikanë.²⁵ Në fazat e fundit të fushatës, një numër llogarish anonime dhe disa gazetarë shpërndanë të dhëna të ndjeshme personale të kandidatit të partisë “Levica” për Qytetin e Shkupit në rrjetet sociale, duke ngritur shqetësime në lidhje me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.²⁶

Kërkesat për raportimin e financimit të fushatës për rrethin e dytë mbetën të kufizuara. Megjithatë, garuesit duhet të dorëzojnë një raport të përkohshëm shtesë një ditë para ditës së zgjedhjeve të rrethit të dytë, në të duhet të raportohen vetëm donacionet.²⁷ E kombinuar me shabllonin e raportimit që nuk ofron një ndarje të donacioneve dhe shpenzimeve sipas komunave, kjo e dëmtoi më tej transparencën, në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare.²⁸ Kodi Zgjedhor parashikon gjoba deri në 9.000 euro në kundërvlerë në denarë për shkelje të rregullave të financimit të fushatës duke përfshirë tejkalimin e kufirit për donacione ose shpenzime ose mosdorëzimin e raportit financiar.²⁹ Pavarësisht ekzistimit të dy organeve mbikëqyrëse, KSHPK-së dhe Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR), dhe numrit të lartë të kandidatëve që nuk i përmbushën kërkesat e raportimit, nuk u iniciuan procedura për sa i përket shkeljeve në lidhje me raportin e parë ose të dytë të përkohshëm, për shkak të mungesës së dispozitës ligjore që e specifikon përgjegjësinë institucionale për iniciimin e një veprimi të tillë. Ky boshllëk e neutralizoi në mënyrë efektive mekanizmin e sanksionimit, duke e dobësuar më tej besimin e publikut në institucionet mbikëqyrëse dhe duke e zvogëluar llogaridhënien e procesit zgjedhor, që është në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare.³⁰

Mediat

Sikurse edhe në rrethin e parë, mediat ishin të obliguara t’i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të balancuar dhe të paanshme. Fondet shtetërore për reklamat politike dhe ndarja e kohës së transmetimit u shpërndanë

²⁴ Shqetësime të tilla u ngritën në Karposh, Kumanovë dhe Studeniçan. Përveç kësaj, më 31 tetor, kandidati i pavarur në Strugë në një konferencë për shtyp [deklaroj](#) se mbështetësit e tij dhe gazetarët ishin sulmuar në rrjetet sociale. Të njëjtën ditë, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë lëshoi një [deklaratë](#) duke dënua çdo presion, sulm dhe gjuhë urrejtjeje ndaj gazetarëve, dhe u bëri apel funksionarëve publikë dhe aktorëve politikë të përmbahen nga kërcënimet, fyerjet dhe përhapja e informacionit të paverifikuar.

²⁵ Më 20 tetor, këshilltari i sapozgjedhur i komunës së Negotinës nga Aksioni Maqedonas - Partia Konservatore (MAAK) publikoi një [postim në Facebook](#) duke përdorur një fyerje raciste kundër komunitetit rom dhe duke sugjeruar që anëtarëve të këtij komuniteti duhet t’u hiqet e drejta e votës. Më 22 tetor, kryetari i partisë “Levica” [postoi](#) në Facebook: “Thjesht thoni këtij përbindëshi të VMRO-së të shkojë në djall të mallkuar dhe kaq. Mos u mundoni të argumentoni me këta pacientë [mendorë], ju lutem, mjaft më.” Duke iu referuar festimit të fitores nga VLEN-i, më 24 tetor, BDI-ja [postoi](#) në Facebook “Hajde, menjëherë të shkojmë në zgjedhje të parakohshme parlamentare!” VLEN-i vuan nga sindromi i Gazimestanit!” Më 27 tetor, “Levica” [publikoi një postim](#) duke iu referuar Kryeministrit Hristijan Mickoski: “A është ky ai që mjekët e quajnë psikopat?”.

²⁶ Mbrojtja e të dhënave personale rregullohet nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i vitit 2020. Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjithashtu ka lëshuar udhëzime mbi përpunimin e të dhënave personale dhe raportimin e shkeljeve të të dhënave personale.

²⁷ 28 nga këto raporte u publikuan në ditën e zgjedhjeve të rrethit të dytë nga KSHPK-ja.

²⁸ Paragrafi 261 i [Udhëzimeve të ODIHR-it të vitit 2020 për Rregulloren për Partitë Politike](#) thekson se “është praktikë e mirë të kërkohen [...] raporte që u japin organeve mbikëqyrëse dhe publikut informacion paraprak mbi të ardhurat dhe shpenzimet e fushatave të partive dhe të kandidatëve disa ditë para ditës së zgjedhjeve”.

²⁹ 1 euro është përafërsisht 61,5 denarë. Raportet e dyta të përkohshme të 167 garuesve duhej të dorëzoheshin më 18 tetor, një ditë para ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë. Sipas KSHZ-së dhe KSHPK-së, vetëm 57 raporte u dorëzuan në kohë, 2 të tjera u dorëzuan 2 ditë më vonë dhe 6 raporte u dorëzuan 3 ditë pas afatit të fundit. Ashtu sikurse edhe te raportet e para të përkohshme, përmbajtja dhe koha e publikimit ndryshonin. KSHPK-ja i publikoi raportet një ditë pas dorëzimit, që përkonte me ditën e zgjedhjeve, ndërsa KSHZ-ja dhe ESHR-ja e bënë këtë tre ditë më vonë. Raporti i fundit i përkohshëm duhet të dorëzohet një ditë pas mbylljes së llogarisë bankare të dedikuar për fushatën dhe mbulon periudhën midis përfundimit të fushatës dhe mbylljes së llogarisë.

³⁰ Paragrafi 276 i [Udhëzimeve të ODIHR-it të vitit 2020 mbi Rregulloren për Partitë Politike](#) thotë se “Në rastet kur ka disa organe monitoruese, legjislacioni përkatës duhet të përcaktojë qartë kompetencat dhe mandatet e tyre të ndryshme dhe të sigurojë që ato e plotësojnë njëra-tjetrën”.

midis garuesve sipas formulës së njëjtë që u zbatua në rrethin e parë, duke i vënë kështu në disavantazh kandidatët e pavarur dhe partitë joparlamentare dhe duke i përjashtuar në mënyrë efektive partitë më të vogla me grup parlamentar.³¹ Në kontekstin e balotazheve për kryetarë të komunave, kjo e shtrembëroi ndjeshëm terrenin për garë, në garat ku kishte kandidatë të pavarur ose kandidatë që përfaqësojnë parti më të vogla, që është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe praktikën e mira ndërkombëtare.³² Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) më 18 tetor vazhdoi monitorimin e saj të mediave dhe raportimin ditor në KSHZ.³³

Monitorimi i mediave nga MVZ-ja e ODIHR-it së zbuloi se toni i mbulimit në programet e lajmeve të të gjithë transmetuesve të monitoruar ishte në përgjithësi neutral. Pasi që kishte më pak kandidatë në rrethin e dytë, transmetuesit e monitoruar u ofruan votuesve informata të mjaftueshme garuesit, duke përfshirë kandidatët e pavarur dhe ata të partive më të vogla politike. Megjithatë reklamimi i paguar politik ishte në favor të partive më të mëdha, kandidatët e pavarur u mbuluan kryesisht në lajme.³⁴ Sikurse edhe në rrethin e parë, mediat online e reflektuan polarizimin politik.³⁵

Zgjidhja e kontesteve zgjedhore

Brenda afatit të përcaktuar, në KSHZ u parashtuan 51 kundërshtime në lidhje me procedurat e ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë, duke përfshirë 19 që kishin të bënin me procesin e votimit dhe 32 që ishin në lidhje me përcaktimin dhe nxjerrjen e rezultateve. KSHZ-ja i shqyrtoi të gjitha kundërshtimet në një mbledhje publike më 23 tetor, duke i hedhur poshtë 8 si të papranueshme ose të parashtuara jashtë procedurave të përcaktuara dhe duke i refuzuar 43 të tjerat si të pabazuara.³⁶ Në disa raste, KSHZ-ja nuk e ndoqi rregullin për shqyrtimin e kundërshtimeve sipas rendit të dorëzimit, por i grupoi ato që kishin të bënin me të njëjtat komuna ose kundërshtues.³⁷ Në përputhje me procedurat, përfaqësuesit e të gjithë kundërshtuesve u ftuan në mbledhje, dhe të pranishmit u dëgjuan përpara se të merreshin vendimet. Jo

³¹ Në Qytetin e Shkupit dhe në Komunën Qendër të Shkupit, VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja, secila prej të cilave kishte qasje në 45 për qind të buxhetit të ndarë për fushatën në media, garuan në rrethin e dytë kundër kandidatëve të partisë “Levica” dhe ZNAM-it, të cilët nuk kishin të drejtë të përfitonin fonde. Në 8 komuna të tjera, kandidatët e pavarur dhe 1 kandidat nga një parti joparlamentare, të cilët kishin të drejtë për të përfituar 3 për qind të fondeve, garuan kundër kandidatëve të partive kryesore, të cilëve u ishin ndarë 45 për qind e fondeve.

³² Paragrafi 7.8 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990](#) i obligon Shtetet pjesëmarrëse të garantojnë se “asnjë pengesë ligjore ose administrative nuk duhet ta pengojë qasjen e papenguar në media, duke mos diskriminuar mbi asnjë bazë, për të gjitha grupet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor”. Seksioni I.2.3 i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) i Komisionit Evropian për Demokraci nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venedikut) të Këshillit të Evropës parashikon që mundësitë e barabarta duhet të garantohet si për partitë ashtu edhe për kandidatët, ndër të tjera, edhe në lidhje me kohën transmetuese të mediave dhe mjetet publike, dhe se varësisht nga tema, barazia mund të jetë e rreptë ose proporcionale. Paragrafi 233 i [Udhëzimeve të Përbashkëta për Rregulloren për Partitë Politike](#) të ODIHR-it dhe i Komisionit të Venedikut, parashikon që mjetet publike duhet të “ndahen në mënyrë jopartiake, në bazë të kritereve të drejta dhe të arsyeshme”, ndërsa paragrafi 235 parashikon se “sistemi për përcaktimin e shpërndarjes proporcionale (ose të drejtë) të mbështetjes shtetërore financiare ose në natyrë duhet të jetë objektiv, i drejtë dhe i arsyeshëm”.

³³ Më 19 dhe 20 tetor, ASHMAA inicioi katër procedura kundërvajtëse kundër katër stacioneve televizive (dy televizione kabllorë dhe dy stacione televizive lokale) për shkelje të heshtjes zgjedhore në rrethin e parë.

³⁴ *Kanal 5* dhe *Telma* mbajtën debate televizive për komunën e Kumanovës. Në kohën me shikueshmëri më të madhe, *RTM 1* mbajti debate televizive për Probishtipin dhe Vallandovën, ndërsa asnjë kandidat nuk shprehu interes për debat në *RTM 2*. *TV Alfa* transmetoi debate për komunën Qendër të Shkupit dhe për Vallandovën, *Kanal 5* gjithashtu organizoi debate televizive për Aerodromin dhe Qytetin e Shkupit, si dhe *Telma* – për Aerodromin, Karposhin, Probishtipin dhe Vallandovën, ndërsa ishin planifikuar debate për Qytetin e Shkupit, mirëpo kandidati i VMRO-DPMNE-së refuzoi të merrte pjesë.

³⁵ Me përjashtim të “*Slloboden Peçat*”, i cili në të dy rrethet raportoi ekskluzivisht me një ton neutral.

³⁶ Tre kundërshtime kishin të bënin me zgjedhjet për kryetar komune në Gostivar dhe u hodhën poshtë nga KSHZ-ja me arsyetimin se zgjedhjet atje do të përsëriteshin, edhe pse në kohën e shqyrtimit të kundërshtimeve nga KSHZ-ja nuk ishte shpallur asnjë vendim formal për përsëritjen e zgjedhjeve. Pesë kundërshtime të tjera u hodhën poshtë sepse ishin parashtuar në mënyrë elektronike.

³⁷ [Udhëzimi i KSHZ-së për mënyrën dhe procedurën për zgjidhjen e kundërshtimeve në kompetencë të KSHZ-së](#) përcakton se kundërshtimet duhet të shqyrtohen sipas radhës së dorëzimit të tyre.

të gjitha ankesat u shqyrtuan individualisht, pasi disa prej tyre u vendosën në mënyrë të përbashkët për shkak të përmbajtjes së ngjashme, ndërsa në disa raste KSHZ-ja zbatoi një qasje tejet formaliste.³⁸ Për më tepër, KSHZ-ja, në vendimet e saj, u dha ankuesve udhëzime të pasakta për mjetet juridike që i kishin në dispozicion.³⁹ Këto mangësi, së bashku me afatet e ngushta, e kufizuan hetimin e disa rasteve. Zbatimi i paqëndrueshëm i ligjit dhe i udhëzimeve të KSHZ-së e dobësoi më tej të drejtën për mjet juridik efektiv dhe ngriti shqetësime në lidhje me procesin e rregullt ligjor, gjë që është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare.⁴⁰

Midis dy rretheve, KSHZ-ja gjithashtu pranoi 30 kundërshtime që lidhen me regjistrimin e votuesve dhe votimin në shtëpi, me ç'rast pranoi 22 dhe refuzoi 8 kundërshtime.

Ndaj katërmëdhjetë vendimeve të KSHZ-së u parashtruan ankesa në Gjykatën Administrative, e cila e miratoi vendimin e KSHZ-së në 10 raste. Pasi i shqyrtoi materialet zgjedhore në një rast dhe kreu rinumërimin e fletëvotimeve në tre raste të tjera, në përputhje me procedurat, edhe atë në mënyrë të plotë dhe efektive në mbledhje publike, Gjykata i miratoi ankimet në katër raste.⁴¹ Gjykata i rrëzoi vendimet e KSHZ-së në këto raste dhe i anuloi rezultatet në tre vendvotime në Shuto Orizarë, me ç'rast njëra kishte të bëjë me zgjedhjet për kryetar komune dhe tre ishin për zgjedhjet për këshilla komunalë. Gjykata vendosi në trupa prej pesë gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj, dhe ua dha palëve në proces mundësinë të dëgjoheshin dhe i publikoi vendimet e saj menjëherë, përkundër afateve të shkurtra.⁴²

Dita e zgjedhjeve

Në përputhje me metodologjinë e ODIHR-it dhe në mungesë të vëzhguesve afatshkurtër në rrethin e dytë, MVZ-ja e ODIHR-it nuk i vëzhgoi procedurat e ditës së zgjedhjeve në mënyrë sistematike ose gjithëpërfshirëse, por anëtarët e misionit vizituan një numër të kufizuar vendvotimesh dhe KZK-të në 18 komuna.

Në vendvotimet ku u vëzhgua hapja, procedurat u respektuan. Votimi, që u vëzhgua gjatë gjithë ditës, u vlerësua si i organizuar mirë, profesional dhe i qetë. Në numrin e kufizuar të vendvotimeve të vëzhguara, në përgjithësi u respektuan procedurat e përcaktuara dhe vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it nuk

³⁸ Për shembull, mospranimi i kundërshtimeve sepse u dorëzuan në mënyrë elektronike, ose mosshqyrtimi i kundërshtimeve në detaje sepse nuk kishte vërejtje në protokollin e vendvotimit në fjalë, ose shqyrtimi i përbashkët i kundërshtimeve të parashtruara nga i njëjti kandidat në vend që të shqyrtoheshin sipas rendit të dorëzimit.

³⁹ Në vendimet e saj, KSHZ-ja i njofton ankuesit se ankesat kundër vendimeve të saj mund të parashtrohen në Gjykatën Administrative nëpërmjet KSHZ-së, ndërsa Kodi Zgjedhor përcakton vetëm se ankesat kundër vendimeve të KSHZ-së mund të parashtrohen në Gjykatën Administrative, pa specifikuar se kjo duhet të bëhet nëpërmjet një organi ndërmjetës.

⁴⁰ Paragrafi 5.10 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990](#) parashikon se “Çdokush do të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe për ta siguruar integritetin ligjor.” Paragrafi 13.9 i [Dokumentit të Vjenës të OSBE-së i vitit 1986](#) i detyron shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që të zbatojnë në mënyrë efektive mjetet juridike, duke përfshirë “të drejtën për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm para një gjykate të pavarur dhe të paanshme, duke përfshirë të drejtën për të paraqitur argumente ligjore”. Seksioni II.3.3b i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) të Komisionit të Venedikut rekomandon se “procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe pa formalitete, veçanërisht për sa i përket pranueshmërisë së ankesave.”

⁴¹ Rinumërimet zbuluan disa parregullsi serioze në protokollin e KZ-ve dhe lëshime në materialet zgjedhore. Këto përfshinin një faqe që mungonte në një protokoll të një KZ-je, mospërputhje midis shifrave të regjistruara në të gjitha protokollin e rezultateve të KZ-ve dhe rezultateve të rinumërimit, mungesën e vulave të sigurisë në një kuti votimi dhe paketimin e gabuar të materialeve zgjedhore.

⁴² Sipas ligjit, Gjykata Administrative duhet t'i shpallë vendimet e saj brenda dy orëve nga përfundimi i seancës gjyqësore. Në një rast, Gjykata u vonua dy orë për shkak të lëshimeve teknike nga KSHZ-ja, e cila i kishte dorëzuar Gjykatës materiale zgjedhore të gabuara dhe nuk kishte siguruar numër të mjaftueshëm të vulave të sigurisë, duke shkaktuar vonesë në proces dhe, rrjedhimisht, në shpalljen e vendimit. Gjykata i kritikoi publikisht përfaqësuesit e KSHZ-së për mungesë profesionalizmi, duke theksuar se lëshime të ngjashme nga ana e KSHZ-së janë përsëritur në disa cikle zgjedhore radhazi.

raportuan incidente ose mangësi serioze procedurale. Përsëri u vunë re disa probleme teknike me identifikimin biometrik të votuesve. Përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve ishin të pranishëm në pothuajse të gjitha vendvotimet e vëzhguara, dhe MVZ-ja e ODIHR-it nuk vërejti asnjë ndërhyrje në punën e KZ-ve. Megjithatë, ajo vëzhgoi raste të shumta ku individë që nuk ishin anëtarë të KZ-ve mbanin evidencë të votuesve që kishin votuar, që mund të jetë tregues për presion të mundshëm mbi votuesit dhe për përpjekje për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në zgjedhjen e tyre.

Numërimet e votave që u vëzhguan nga MVZ-ja e ODIHR-it u vlerësuan si transparente dhe efikase dhe në përgjithësi u kryen në përputhje me procedurat e përcaktuara, me disa përjashtime ku hapat e paraparë për harmonizimin e rezultateve nuk u zbatuan ose nuk u kryen në rendin e duhur. Nuk u vunë re mosmarrëveshje mbi vlefshmërinë e fletëvotimeve dhe KZ-të e vëzhguara nuk patën vështirësi në plotësimin e protokolleve të rezultateve. Në vendvotimet e vëzhguara, nxjerrja e rezultateve ishte e organizuar mirë, profesionale dhe transparente, me pranim efikas të materialeve zgjedhore dhe verifikim të protokolleve, dhe e kryer në përputhje me procedurat e përcaktuara.

KSHZ-ja njoftoi se pjesëmarrja ishte 41,76 për qind. Ajo filloi t'i publikonte rezultatet e pjesshme paraprake të zgjedhjeve në faqen e saj të internetit, deri në nivel të vendvotimeve, rreth orës 19:45 më 2 nëntor, dhe i shpalli rezultatet paraprake në orën 21:50, duke kontribuar në transparencën.

Rregullat për heshtjen zgjedhore në përgjithësi u respektuan, mirëpo u raportuan disa shkelje. Vlen të përmendet se lideri i VMRO-DPMNE-së dhe njëkohësisht kryeministër, Mickoski, në një deklaratë për mediat, e promovoi partinë e tij dhe kandidatët e saj. KSHZ-ja i tërhoqi akreditimet e tetë vëzhguesve nga organizata “Zgjohu” për shkak të zhvillimit të fushatës para një vendvotimi në Shuto Orizarë dhe e informoi Prokurorinë për incidentin.

***Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë në dispozicion përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.***

INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

Shkup, 3 nëntor 2025 – Vlerësimi u krye për të përcaktuar nëse zgjedhjet ishin në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet tjera ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike, si dhe me legjislacionin kombëtar. Ky vlerësim duhet të lexohet së bashku me Deklaratën për Gjetjet dhe Përfundimet Paraprake, të publikuar më 20 tetor pas ditës së zgjedhjeve të rrethit të parë.

ODIHR ka miratuar Deklaratën e parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005. Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake dorëzohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit, duke përfshirë nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e kundërshtimeve dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. ODIHR-i do të publikojë një raport gjithëpërfshirës përfundimtar, duke përfshirë rekomandime për përmirësime eventuale, disa muaj pas përfundimit të procesit zgjedhor.

Matteo Mecacci është shef i MVZ-së së ODIHR-it, që filloi me punë më 5 shtator. Vëzhgimi i rrethit të dytë nga ana e MVZ-së së ODIHR-it përfshiu 11 ekspertë në ekipin kryesor dhe 2 zyrtarë të ODIHR-it në Shkup, si dhe 10 vëzhgues afatgjatë. Vëzhguesit e ODIHR-it për rrethin e dytë erdhën nga 17 vende. Nëntë nga 23 vëzhguesit e ODIHR-it ishin gra.

MNVZ-ja dëshiron të falënderojë autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut për ftesën e tyre për të vëzhguar zgjedhjet, dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për ndihmën e tyre. MNVZ-ja dëshiron po ashtu të shprehë falënderimin e saj ndaj institucioneve të tjera shtetërore, partive politike, kandidatëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare për bashkëpunimin e tyre.

Për informata plotësuese ju lutemi kontaktoni:

- Matteo Mecacci, Shef i MVZ-së së ODIHR-it në Shkup (+389 71 393185);
- Katya Andrusz, Zëdhënëse e ODIHR-it (+48 609 522266), ose
- Ranko Vukčević, Këshilltar për zgjedhjet e ODIHR-it (+48 723 960008).

Adresa e MVZ-së së ODIHR-it:

Georgi Dimitrov 16

1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

telefoni: +389 71 393185; e-mail: office@odihr.mk